



**VENDIM**

**Nr.124, Datë 21.07.2016**

**MBI**

**MIRATIMIN E RREGULLAVE TË MENAXHIMIT TË KAPACITETIT  
TE KUFIZUAR**

Në mbështetje të neneve 16; 67 pika 1 të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe nenit 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE“ miratuar me Vendimin e Bordit të ERE, Nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.07.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës për miratimin e “Rregullave të menaxhimit të kapacitetit të kufizuar” dhe draftin përkatës,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria OST sh.a me shkresën nr. 5171/5 Prot., datë 15.12.2015 ka depozituar në ERE për miratim konform nenit 65 pika 1 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“, “Rregulloren e menaxhimit të kapacitetit ndërkufitar“.
- Bordi I ERE me vendimin nr.5, datë 27.01.2016, filloi procedurat për miratimin e “Rregullave të Menaxhimit të Kapacitetit Ndërkufitar”.
- ERE me shkresën Nr. 26/2 Prot., datë 03.02.2016, publikoi për 3 ditë me rradhë në median e shkruar njoftimin për kete vendimmarrje të Bordit.
- Me shkresën nr. 132 Prot., në datë 04.02.2016, ERE dërgoi draft “Rregulloren e Menaxhimit të Kapacitetit Ndërkufitar” për marrje mendimi, pranë subjekteve: MEI, OSHEE sh.a., KESH sh.a., OST sh.a., FIAA, AREA, Autoriteti i Konkurrencës, AEES dhe ACERC.

- Pas përfundimit të afatit 15 ditor të marrjes së mendimeve nga palët e interesuara, rezultoi se nuk është paraqitur asnjë koment.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

- 1.** Miratimin e Rregullave të Menaxhimit të Kapacitetit të kufizuar.( Rregullat bashkëlidhur këtij vendimi)
- 2.** Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.